



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Raporti i Kuvendit Komunal janar-qershor 2019

Kuvendi i Komunës së Drenasit gjatë periudhës janar- qershor 2019 ka mbajtur mbledhjet si vijon dhe ka këto të dhëna:

Gjatë periudhës janar-qershor 2019 Kuvendi Komunal ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje:
6 mbledhje të rregullta.
2 mbledhje Solemne.
1 mbledhje Urgjente dhe 1 mbledhje të jashtëzakonshme.

Gjatë kësaj periudhe që po raportojmë Kuvendi i Komunës ka aprovuar 40 Vendime
1 Rregullore, rregullore Komunalë për Transparencë.
Gjithsej akte të aprovuara: 41.

Kuvendi i Komunës ka të themeluar dy komitete obligative si:

Komiteti për Politikë dhe Financa - gjatë periudhës janar-qershor ka mbajtur: 6 mbledhje dhe Komiteti për Komunitete-ka mbajtur: 1 mbledhje.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe komitete konsultative funksionale kanë qenë: Komiteti konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport i cili ka mbajtur 1 takim, dhe në bazë të vendimit nr.12.06.9003 të dt. 19.02.2016 komitetit konsultativ për Arsim Kulturë Rini dhe Sport i ka përfunduar mandati dhe komitetit konsultativ për zhvillim Ekonomik, mbrojtje të ambientit, shëndetësi dhe mirëqenie sociale
Komiteti Konsultativ për Barazi Gjinore- nuk ka mbajtur takime

Pas përfundimit të mandatit të dy komiteve konsultative janë themeluar me vendim të Kuvendit Komunal serish si Komitetit Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport dhe Komitetin Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i cili nuk ka mbajtur asnjë takim, dhe Komiteti Konsultativ për Përsosmëri me Aftësi të Kufizuara po ashtu është themeluar.

Vendimet e Kuvendit Komunal të aprovuara gjatë periudhës janar-qershor 2019

Janar, 2019

Mbledhja e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 31.01.2019 i cili miratoi këto vendime:

1. Vendim për Aprovimin e Programit Komunal Tre vjeçar për Banim për Periudhën 2019-2021
2. Vendim për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Organizatave të Biznesit në Komunën e Drenasit.
3. Vendim Për përkrahjen-subvencionimin e KRM “Pastrimi” SH.A

Shkurt, 2019

Mbledhja e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 27.02.2019 i cili miratoi këto vendime:

1. Vendim për formimin e komisionit për përgatitjen e Rregullores për Organizimin e Punës në Institucionet Edukative - Arsimore në Komunën e Drenasit.
2. Vendim për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha.
3. Vendim për formimin e komisionit për çështjet e banimit të përkohshëm social.
4. Vendim i planit të veprimit për përmbushje të transparences 2019-2023.
5. Vendim për ndryshimin të emrit të projektit për shpenzime kapitale.

Mars, 2019

Mbledhja e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 27.03.2019 i cili miratoi këto vendime:

1. Vendim për Aprovimin e Programit Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2019-2021, i plotësuar.
2. Vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. Vendim për rritjen e të hyrave vetanake nga viti 2018.
5. Vendim për bartjen e të hyrave vetanake për vitin 2018.
6. Për formimin e ndërmarrjes publike, nga ish NP “KosovaTrans”, në ndërmarrje Publike Lokale, Stacioni i Autobusëve-Glllogoc, Shoqëri Aksionare.
7. Vendim Për vendosjen e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin “Fehmi Lladrovci”.
8. Vendim për lejimin e rrënimit të objekti që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale Drenas, ish objektit për sigurime sociale.

Prill, 2019

Mbledhja e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 25.04.2019 i cili miratoi këto vendime:

1. Vendim për vendosjen e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin “ Fehmi Lladrovci” i plotësuar.
2. Vendim për lejimin e rrënimin të objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale në Drenas, ish objekti për sigurime sociale, i plotësuar
3. Vendim për lejimin e largimit/demolimit të disa ndarjeve, sporteleve dhe kryerjen e disa punimeve brenda hapësirës së QKMF-së “Dr. Hafir Shala” në Drenas.
4. Vendim Për të hyrë ne bashkëpunim ndër komunal me:
 - a) Komunën e Vushtrrisë,
 - b) Komunën e Skenderajt,
 - c) Komunën e Obiliqit.
5. Vendim për të hyrë ne bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Vushtrrisë.
6. Vendim për të hyrë ne bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Obiliqit.
7. Vendim për të hyrë ne bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Lipjanit.
8. Vendim për të hyrë ne bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Fushë Kosovës.
9. Vendim për të hyrë ne bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Malishevës.
10. Vendim për të hyrë ne bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Klinës.
11. Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
12. Vendim Për formimin e Komisionit të Ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës .
13. Vendim për plotësimin e komisionit për shqyrtimin e kerkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve,rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit.

Kuvendi Komunal Drenas përbehet nga 31 asamblist, pas dorëheqjes se z.Xhavit Drenori dhe znj.Shqipe Zogu gjatë mbledhjes së mbajtur më **25.04.2019** u zëvendësuan më: Xhavit Drenori me Gentrit Gerguri me subjekt politik [Vizioni per Drenasin](#) dhe në vend të Shqipe Zogu e zëvendësoi Florentina Kukaj me subjekt politik Partia Demokratike e Kosovës.

Në muajin prill më: **05.04.2019** u mbajt **mbledhje e jashtëzakonshme**, Kuvendi Komunal miratoi këtë vendim Vendim për të hyrë ne bashkëpunim ndërkomunal me komunën e Skenderajt në fushën e infrastrukturës

Maj, 2019

Mbledhja e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 31.05.2019 i cili miratoi këto vendime:

1. Vendim për ridestitim të mjeteve.
2. Vendim për formimin e këshillit drejtues për NPL-SHA Stacioni i Autobuseve, Gllogoc
3. Vendim për transfer të mjeteve nga kategoria për mallra dhe shërbime në shpenzime kapitale
4. Vendim për plotësim /ndryshimin e komisionit ndryshimin e Stemës dhe Vulës së Komunës së Drenasit.

Qershor, 2019

Mbledhja e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 27.06.2019

i cili miratoi këto vendime:

1. Vendim për rregullore komunale për transparence.
2. Vendim për financim për projektin KH “Drenica”
3. Vendim për financim për projektin KF”Feronikeli”
4. Vendim për financim për projektin KF” Drenasi”
5. Vendim për financim për projektin Këshillit i Veprimit Rinor Lokal(KVRL) Drenas.
6. Vendim Draft Korniza Afatmesme Buxhetore komunale 2020-2022
7. Vendim për zëvendësim të anëtarit të Komitetit për Komunitete.

Drenas, 03.07.2019

Liridona Fejza-Ajazi

Zyrtare për mbështetje Administrative-Teknike